

## SILIKON SANITAR

Silikon sanitar njëkomponentësh.



### Silikon Sanitar

| Nr. art. | Ngjyra      |
|----------|-------------|
| 18922131 | transparent |
| 18922132 | bardhë      |
| 18922134 | bezh        |
| 18922135 | hiri        |

Masë njëkomponentëshe silikonit për aplikim në sanitari dhe përdorim të përgjithshëm. Fortësohet në temperaturë dhome nën ndikimin e lagështisë atmosferike, duke krijuar një lidhje elastike të përhershme. Silikoni sanitar ka ngjitje të shkëlqyer pa prajmer (bazë) në shumicën e materialeve që përdoren për aplikime sanitare, si xhami, pllaka, qeramika, smalt, pllaka të glazuara dhe klinker, dru i llakuar ose i lyster dhe disa plastika. Përdoruesit duhet të kryejnë testet e tyre për shkak të shumëllojshmërisë së materialeve. Ngjitja mund të përmirësohet në shumë raste me trajtim paraprak të sipërfaqeve me prajmer.

### Karakteristikat:

- I përshtatshëm për përdorim në hapësira sanitare
- Rezistent ndaj mykut dhe kërpudhave
- Rezistent ndaj rrezeve UV
- Temperatura e aplikimit: +5°C deri +40°C
- I qëndrueshëm në temperatura të ulëta (-40°C) dhe të larta (+100°C)

### Aplikimi:

- Izolimi i vaskave, dusheve, lavamanëve dhe vende të tjera sanitare
- Izolimi i pllakave qeramike
- Izolimi i dritareve dhe deryeve
- Përdorim i përgjithshëm në ndërtim
- Aplikime DIY (makinë, varkë, rimorkio, shtëpi), veçanërisht në zona me lagështi të madhe

**Aplikimi:** Sipërfaqet që do të jenë në kontakt me masën izoluese duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa materiale të lirshme si pluhuri, papastërtitë, ndryshku, vaji dhe ndotës të tjerë. Sipërfaqet joporoze duhet të pastrohen me një tretës dhe të fshihen me një leckë pambuku të pastër pa fije. Hiqni mbetjet e tretësit para se të avullojnë, duke lënë një sipërfaqe të pastër dhe të thatë.

Afati i përdorimit është i shënuar qartë në etiketën e çdo produkti. Nëse produkti mbahet pas kësaj date, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që nuk mund të përdoret. Megjithatë, në raste të tilla, është e nevojshme të kryhen teste për të verifikuar nëse vetitë e produktit përputhen ende me përdorimin e synuar për të siguruar efikasitetin dhe siguri maksimale.

Ruajeni në paketimin origjinal, në një vend të thatë dhe të freskët (+5°C deri në +25°C), larg rrezeve të drejtpërdrejta të diellit. Produkti ka afat përdorimi 18 muaj.